

Vrasja e katërfishtë, si u shua familja në Kosovë



© 10:03 - 31 Dhjetor, 2020



Një ngjarje tragjike ka ndodhur mbrëmjen e së mërkurës në Kosovë ku një kryefamiljar ka vrarë bashkëshorten dy djemtë dhe më pas dhe veten e tij.

Vrasja e katërfishtë ka ndodhur në Pozhoran të Vitisë. Policia ka dhënë detaje te reja ku thekson se ngjarja e rëndë ka ndodhur pas një konflikti në familje.

“Është raportuar se i dyshuari mashkull, dyshohet se pas një mosmarrëveshje familjare në shtëpinë e tij, i ka qëlluar për vdekje me armë zjarri bashkëshorten, dy djemtë e tij dhe vetveten. Njësit relevante dhe ekipi mjekësor kanë dalur në vendin e ngjarjes ku dhe është konstatuar vdekja e tyre”, thuhet në njoftimin e Policisë së Kosovës.



Djemte e familjes

Policia bën të ditur se me vendim të prokurorit trupat e pajetë janë dërguar në IML për obduksion ndërsa si dëshmi materiale është sekuestruar një pistoletë e cila dyshohet të jetë përdorur në raste.

Ndërkaq kujtojmë se një ngjarje e ngjashme ka ndodhur më 18 shkurt të këtij viti në Komunën e Gjilanit, ku një zyrtare policore vrau katër anëtarë të familjes së saj dhe më pas edhe veten.

Valdete Bllaca e cila ishte zyrtare policore në rajonin e Gjilanit, kishte privuar nga jeta babain Zeqir Bllaca i moshës 70 vjeçare, nëna Hanife Bllaca 66 vjeçare, dy vëllezërit e saj Blerim Bllaca 43 vjeçar dhe Fisnik Bllaca 34 vjeçar, si dhe në fund edhe veten./abcnews.al

RajoniFamiljeKosove

Të ngjashme

Hoti: Lutje dhe mirënjohje për të prekurit nga pandemia

Festat e penguara nga varfëria: Familja Kola pa tryezën e Vitit të Ri, tërmeti u shembi shtëpinë

Kosova regjistron 184 raste pozitive për Covid-19, tre qytetarë humbën jetën në 24 orë



© 23:05 - 31 Dhjetor, 2020

Disa mënyra si ta çlironi trupin nga stresi dhe dhimbja

© 22:32 - 31 Dhjetor, 2020

Varianti i ri i COVID-19 mbërrin në Brazil, identifikohen dy raste...

© 22:24 - 31 Dhjetor, 2020

“Fiton kush e çon në motel”, deklarata e vitit bëhet nga trajneri i Gremio

© 22:10 - 31 Dhjetor, 2020

Ardi Veliu: Në vitin 2020 u ul numri i vrasjeve dhe aksidenteve me pasojë...

© 20:46 - 31 Dhjetor, 2020

Urimi i ambasadës së SHBA: Ngritja e Gjykatës Kushtetuese hap drejt...

© 18:31 - 31 Dhjetor, 2020

ABC tek “Shefqet Ndroqi”, orët e fundit të 2020 për pacientet që luftojnë me...

© 16:19 - 31 Dhjetor, 2020

Festat e penguara nga varfëria: Familja Kola pa tryezën e Vitit të Ri, tërm...

© 13:59 - 31 Dhjetor, 2020

“ABC e festave”, program special për natën e ndërrimit të viteve

ABC NEWS AL
info@abcnews.al
+355 67 400 9040

Rreth nesh

ABC NEWS është i pari televizion në Shqipëri që në ditën e parë të transmetimeve nis me lidhje direkte nga 7 studio lokale ne Shkodër, Durrës, Elbasan, Korçë, fier, Vlorë e Gjirokastr. Për të pasuruar gjeografinë e informacionit së shpejti do të mundesohet edhe studio nga Lezha me transmetime live në cdo kohë. Në faqen zyrtare në internet, abcnews.al do të gjeni portalin më të pasur ballkanik me lidhje në rrjetet më të mëdha sociale facebook, twitter si dhe në një prej websiteve më të fuqishëm në kulturën e internetit YOUTUBE. Transmetimi i ABC news është live 24 ore. NUIS/NIPT K01711004F

Harta e faqes

Aktualitet	Botë	English
Politikë	Ekonomi	Life
Rajon	Emisione	
Sport	Moti	

